



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.333/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Bujar Muzaqi dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë e Subjektit Politik Socialdemokratikan Unija-SDU, paraqitur kundër Subjektit Politik Koalicioni Vakati, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Socialdemokratikan Unija-(SDU), Anr.333/2025 e datës 03.02.2025.
- II. Subjektit politik Koalicioni Vakati, për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1500 ( njëmijepesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Koalicioni Vakati, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 03.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.333/2025, nga Subjekti Politik Socialdemokratikan Unija-SDU, me seli në Prizren kundër subjektit politik Koalicioni Vakati, me seli në Prizren, me të cilën pretendohet se ne promocione të këtij koalicion të mbajtura Lubinjë,..., Manastiricë dhe Gornje Selo, ka pasur të pranishëm edhe fëmijë të vegjël, me të cilën konfirmohet edhe nga kryetari i kësaj partie, Rasim Demiri. Sipas pretendimeve e në ankesë i njëjti thekson se fëmijët janë shfrytëzuar për qëllime politike nga Koalicioni Vakati.

Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur fotot të postuara në facebook nga tubimi i subjektit Koalicioni Vakati.

Më datë 04.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik VAKAT, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 04.02.2025.

Në Përgjigjen në ankesën Anr.333/2025, në lidhje me ankesën drejtuar kundër Koalicionit Vakati nga Duda Balja, kryetare e SDU-së, theksojnë se duke u bazuar në nenin 5, i cili i referohet të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve politike gjatë tubimeve politike dhe pikës 3 të këtij neni, Koalicioni Vakati nuk miraton praninë e të miturve në tubimet e tyre, andaj të miturit që shihen në foto janë fëmijë të kandidatëve të listës së Koalicionit Vakati, të cilët kanë marrë pëlqimin e prindërve për të marrë pjesë në tubime. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se Koalicioni Vakati, është i vetëdijshëm për rregullat e sipërpërmendura, dhe se në këto tubime nuk ka lejuar të miturit të mbajnë asnjë simbol të Koalicionit dhe as të kandidatëve të listës sonë që janë prindërit e tyre. Me tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se edhe një herë kërkojnë që të merren parasysh shpjegimet tonë, sepse bëhet fjalë për tubime të lajmëruara në mënyrë të rregullt të cilat i monitorojnë vëzhguesit e Bashkimit Evropian dhe anëtarët e OSBE-së, ndaj dhe Koalicioni VAKAT nuk lejon asnjë shkelje të kodit të mirësjelljes. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se në lidhje me ankesën e bërë kundër Koalicionit VAKAT për shkak të pranisë së të miturve në një nga tubimet e tyre në fushatë, dhe paraqesin fakte që tregojnë qartë se nuk kanë shkelur asnjë ligj apo rregullore zgjedhore, dhe se tubimet e Koalicionit VAKAT janë ngjarje publike, ku sipas rregullores aktuale zgjedhore, tubimet zgjedhore janë të hapura për publikun dhe mund të marrin pjesë të gjithë qytetarët, ashtu që organizatorët e tubimit nuk kanë ftuar të mitur dhe nuk kanë qenë pjesëmarrës në promovimin politik dhe se prezenca e tyre ishte ekskluzivisht pasive, dhe nuk mbanin në dorë asnjë pankartë, simbol të Koalicionit Vakati si dhe nuk merrnin pjesë në propagandë politike.

Në përgjigje në ankesë theksojnë se si organizatorë, nuk kanë të drejtë ligjore të pengojnë fizikisht dikë që të marrë pjesë në një ngjarje publike, dhe se sipas Ligjit Zgjedhor të Kosovës dhe rregulloreve përkatëse të KQZ-së, prania e të miturve në tubime parazgjedhore nuk përbën shkelje të ligjit përderisa ata nuk janë pjesëmarrës aktivë në fushatë, gjë që nuk ishte rasti në këtë rast. Duke u bazuar në atë që u cek me lart, duket qartë se Koalicioni Vakati nuk ka shkelur asnjë rregullore zgjedhore dhe se ankesa nuk ka bazë ligjore. Andaj kërkojnë që ankesa të hidhet poshtë si e pazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### **Ankesa është e pazuar**

Paneli ka gjetur se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik

Koalicioni Vakant në tubimin e mbajtur për fushatën zgjedhore, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore*".

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik Koalicioni Vakant në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga fotografitë e ofruara si dëshmi nga subjekti politik SDU shihet se në tubimin e fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni Vakant, e mbajtur në disa fshatra të Komunës së Prizrenit kanë marrë pjesë edhe fëmijë, me qëllim të përfitimit të votave.

Andaj paneli vlerëson se veprimet tilla janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik Koalicioni Vakant, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.333/2025 datë 05.02.2025

Kryesues i Panelit  
Kujtim Pasuli



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.